



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:033405

Datë: 30.06.2020

Numri i dokumentit: 00998710

P.nr. 101/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGANË LIPJAN, nga gjyqtari Selman Salihi, me pjesmarrjen e sekretares juridike Hanife Ibrahimimi, në lëndën penale kundër të akuzuarës R. B. nga fshatgi M., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.nr.6401/13, të dates 29.10.2013, për shkak të veprës penale Demtimi asgjësimi dhe heqja e pajisjeve mbrojtëse, nga neni 358 par 5 lidhur me par 3 të KPK-se, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.29.12.2016 në praninë e prokurorit të Shtetit Merita Lumezi, të pandehurit, me datën 21.06.2019, në të njëjtën ditë muarr dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara R. B., e bija e H. dhe M., e gjinisë B., e lindur me *data e lindjes...* ne fshatin M., jeton ne fshatin Q., Komuna e Lipjanit, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse

Si person përgjegjës në objektin ku zhvillon biznesin e saj, nga pagujdesia ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e detyrimeve në vendin e punës nuk ka instaluar pajisjet mbrojtëse dukëmos vepruar sipas rregullave teknike mbi masat mbrojtëse dhe në këtë mënyrë ka shkaktuar rrezik të madh prej jetës dhe shëndeti që rezultuar me lëndim të rëndë trupor, në atë mënyrë që e pandehura në cilësinë e drejtoreshes së Ndermarrjes tregëtare punuese “B. C. “ në seli në fshatin M., komuna Lipjanit, për shkak të mos sigurimit të shkallëve me parrake të cilat shkallë janë në katin e dytë të këtij objekti, me datën 18.06.2012 në objektin e lartëcekur, I demtuar R. A. është rrezuar nga kati I dytë I objektit dhe ka rënë në pushimorën e shkallëve, në qerast ka pasur lëndime të rënda trupore.

-Me këtë e pandehura ka kryer veprën penale Demtimi, asgjësimi dhe heqja e pajisjeve mbrojtëse, nga neni 358 par.5 lidhur me par. 3 dhe 2 të KPK-se

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të nenëve, 1,2,3 4, 23,41,42, 43,45, 46,47, 73,74,76 të KPK-se, dhe 360, par.2 dhe 1 dhe nenit 365, të KPPRK-se,

G J Y K O N

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qofte se në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veper penale të re. Te akuzuarës me pëlqime e saj i zëvendësohet denimi me burg dhe me gjobe konform nenit 47 të KPRK-se dhe ate ne shume prej 1500 € i cili do të ekzekutohet pas plotfuqishmëris se këtij aktgjykimi.

OBLIGOHET e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ti paguaj shumën prej 40 € ne emër të paushallin gjyqësor, si dhe shumën prej 30 euro ne emër të mbrojtës të viktimave të krimit ne afat prej 15 dite nga plotfuqishmeria e ketij aktgjykimi

Me qense i dëmtuari, është drejtuar gjykatës me padi për realizimin e zhdëmtimit në kontest civil, atëherë konsiderohet se veq ka parashtruar kërkesën pasuroro-juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.nr.6401/13, të datës 29.10.2013, ka akuzuar R. B. , për shkak të veprës penale Demtimi asgjesimi dhe heqja e paisjeve mbrojtëse nga neni 293 par 6 lidhur me par 3 dhe lidhur me par 2 të KPK.

Gjyqtari I vetëm gjykues duke u mbështetur në dispozitat ligjore të KPRK-es dhe KPPRK-es , referuar edhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PA1.nr 11230/2019 të datës 11.02.2020 e duke u mbështetur provat mbi faktet të cilat në shkallë të caktuar dhe janë administruar dhe analizuar edhe me aktegjykimin I cili tash është anuluar dhe është kthyer në rryshqyrtim qeshtja penale .Me këte jashtë séance morri dhe aktvendim të keti aktvendimi.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 09.06.2020 në prani të prokurorit të shtetit të akuzuarit dhe mbrojtësit të akuzuara gjykata e ven çështjen penale në shqyrtim dhe me qense tani qeshtja penale fillon nga fillimi ,duke mos qenë prezent I dëmtuari R.A. dhe deshmitarja F. A. dhe deshmitari D. G. .Me pajtimin edhe të prokurorit të shtetit dhe paleve në procedurë janë administruar provat .Në këte contest e akuzuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor është deklaruar e pa fajshme .Prokurori I shtetit mbetet pran aktakuzës në paraqitjen e fjalës hyrse duke deklaruar se aktakuza është e mbështetura në prova të propozuar do të vërtetohet gjendja faktike e përshkruar në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi I të akuzuarit deklaroi se mbës në tersi pran deklaramit të cilat I kemi dhënë me parë në këte qeshtje penale dhe njëherit shtoi duke I mbrojtur vendimet e shkallës së dytë të cilat të gjitha janë rekomandohen gjykatës në këte procedurë të eliminoj të gjeturat .I njëjti deklaroi se vërejtjet e dhëna nga shkalla e dytë janë edhe sa I përket lëndimeve trupore në të cilën mbrojtësi I të akuzuara thirret në atë. Me këte rastë meqense prokurorja e shtetit u deklaruar se pajtohet me leximin e shkresave përkatësisht deklaratave siq janë në procesverbalet bashkangjitur lëndës e që natyrisht palet në procedurë nuk kanë vërejtje . Me këte gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur ka bërë leximin e procesverbaleve e shkresave të lëndës si vijonë .

-lexohet procesverbali I shqyrtimit fillestar I dt. 09.06.2015 perkatesisht procesverbali I shqyrtimit fillestar I dt. 16.06.2015 sipas gjyqtarit te veetem gjykues perkatesisht duke ju referuar nenit 312 ku dhe eshte bere ndryshimi I grupit gjykues dhe gjyqtarit te vete.

- Lexohet procesverbali ishqyrtimit te dyte ted t. 16.06,2015 .
- Lexohet procesverbali I dates 22.12.2016 .
- lexohet procesverbali I dates 02.02.2016.
- Lexohet procesverbali I dt. 27.02.2017.
- Lexohet procesverbali I dt. 21.03.2017.
- Lexohet procesverbali I shqyrtimit gjyqesor I dt. 25.05.2017.
- Lexohet procesverbali I shqyrtimit gjyqesor I dt. 29.05.2018.
- Lexohet procesverbali I shqyrtimit gjyqesor I dt. 20.06.2018.
- Lexohet procesverbali I shqyrtimit gjyqesor I dt. 21.07.2018.
- Lexohet procesverbali I 26.07.2017.
- Lexohet procesverbali I shqyrtimit gjyqesor I dt. 27.09.2018.
- lexohet procesverbali I shqdyrtimit I dt. 03.07.2017
- Lexohet procesverbali I shqyrtimit gjyqesor I dt. 05.05.2017
- Lexohet shksresa drejtuar prokurorise me dt. 05.06.2018.
- Lexohet procesverbali I shqyrtimit gjyqesor I dt. 26.11.2018
- Lexohet procesverbali I shqyrtimit gjyqesor I dt. 22.01.2019
- Lexohet pprocesverbali I shqyrtimit gjyqesor(ky procesverbal eshte shenuar ne fillim larte emertimit fillestar por ne kete moment meniher kemi te bejme ne shqyrtimin gjyqesor.
- Lexohet procesverbali I dt.12.03.2019
- Lexohet procesverbali gjyqesor I dt. 19.04.2019.
- lexohet procesverbali I dt. 08.04.18
- Lexohet procesverbali I dt. 16.04.2019
- lexohet fjala perfundimtare te paraqitet nga mbrojtesi I te pandehures av Shpetim Sadiku I paraqitur me shkrim dhe e laburuar ne séance .

Po ashtu ne keto gjitha procesvebrale te lexuara dhe te cilat palet I konsiderojn si deklarata te dhena dhe si prova ne procedure .jane edhe deklaratat e deshmitarit D. G.dhe deklarata e te pandehurit dhe te demtuarit R. A. dhe F. A. e natyrisht edhe deklarata te dhena me 26.11.2019 te deshmitarit A. B. dhe G. B. dhe H. R. .Si ispektor I punes e natyrisht si prova te cilat I ka ofruar I demtuari eshte bere leximi natyrisht analizimi edhe I kallximit penal I dt. 08.07.2013 si dhe procesverbali I séances pregaditore .Dhe eshte lexuar dhe raportet e veqant policore .Gjykata pasi qe jane te pershkruara ne procesverbalin e séances se shqyrtimit gjyqesor dhe shkresa tjera edhe ne fazen e hetuesise edhe ne pas ngritjes se aktakuzes dhe deklaratat e dhena sit e pandehurit dhe demtuarit deshmitareve dhene ne polici e ne kete kontest dhe raportet jane lexuar dhe jane si baze raportet mjekesore specialistike siq eshte rapofrit mjekesor I ordinances “etika leberatori “ per te demtuarin R. A. si dhe analizat raportet mjekesore te specialistit opertedik te demtuarin e natyrisht procesverbalet e shqyrtimit gjyqesor ne procedure civile kuk jane bere edhe ekspertizat mjeko ligjore dhe jane dhene mendimet dhe konstatimet e mjekve ligjor te cilet e kane kosntatur shkallen e lendime te demtuarit ne objektin e NTP’B. C. ne M. me 18.06.2012 .

Ne kete aspekt deshmia e deshmitarit D. G. deshmitares F. A. si bashkekshorte e te demtuarit e perderisa D. G. dhene ne polici dhe prokurori pasi qe I njeiti pasi qe te njejtit I eshte lexuar deklarata e tij edhe veq paleve ne procedure siç ka deklaruar se vertet I demtuari kishte rene nga kati I eperm ne platonin e shkalleve te katit te pare me qka ka psuar lendime dhe krejte si pasoj mos venjes apo heqjes se paisjeve e ne kete rast te parmacve forcus perreth shkalles si mbrojtese per te u mbajtur kosumatoret dhe per te mos rrezikuar renjen jashte shkalleve. Deshmitari d. G. eshte deklaruar qartazi se formaket kane qen te vendosur por nuk kane qen te shternguar .

Duke pytyr gjyqtari i vetem gjykues per vrejttet me leximin e shkresave te lendes mbrojttesi i te pandehures se pjeserisht ka vrejttje ne kuptim te mbrojtjes.

Ne fjalen perfundimtare prokurori I shtetit deklaroi se ne baze te provave te administruara deklarates se te demtuarit deklaratave te te deshmitareve deklarates se te demtuarit konsideroj se eshte vertetuar gjendja faktike Prokurorja e shtetit deklaroi se beri ricilesimin e vepres penale ashtu qe tani vepra penale qe e ka kryer e pandehura eshte Asgjesimi, demtimi apo heqja e paisjeve mbrojtese dhe rrezikimi I siguris nga vendi I punes nga neni 358 par 5 dhe 3.2 nr. 06/L-074 te kodit penal te Republikes se Kosoves andaj e njejtja I propozon gjykates qe te njejten te shpall fajtores. Nga se ky ricilesim ne kete contest eshte ne perputhshmeri me veprimet e te pandehures. Ashtu qe reflektohen edhe ne mosveprimet e te pandehures qe e njejtja ne cilesin e pronares se objektit afarist perkatesisht veprimtaris afariste”B. C. “,eshte bindur ne baze te provave mbi bazen e fakteve se e njejtja ka tregetuar me mall ka hapur objektin dhe ne katin e eperm ku pikerisht ka rene I demtuari ka pasur gje sende ne shitje dhe farmaket(gilinderat qe jane te pershkruar ne shkresat e lendes shifet edhe nga faktet nuk I ka perforcuar apo dikun dikun as fare nuk I ka vendosur.Eshte dashte qe te kete siguri fizike per kosumatoret ku shkojne per blerje .Apo ,ato nuk kane qen te vendosuraq apo te forcuar ne menyre te sigurt eshte dashte te paralajmroj apo te caktoi nje percjelles – puentor per te u kujdesur apo per te orjentuar me kosumatoret ku ka qen R. A..Lendime trupore jane konstatuar ne baze te raporteve mjekesore siq kemi theksuar me larte ku jane lexuar dhe ato jane bashkangjitur lendes e qe jane fakte se I demtuari eshte kontrolluar ka kryer kontrollat mjekesore ka mare vazhdimisht terapi Pastaj intervendimi edhe I organeve dhe I policies dhe vete fakti edhe I dergimit ne QKUK pot e njejten dite raportet mjekesore diktojn dhe percaktojn shkallen e lendime te te demtuarit .Gjykata ne shkresat e lendes sikurse jane te lexuar me heret dhe jane si prove fleteleshimi I te demtuarit me nr. 1002 eshte mjekuar nga dt. 18.06.2012 ditën dhe kur eshte shtrir ne spital kur dhe ka ndodhur ngjarja ku ka rene nga kati I siperm e leshuar nga spitali ka qendruar ne klinik deri me dt.29.06.2012 ku eshte konstatuar nga mjeket specialist se me 22.06.2012 te I njejtja ka pasur nderhyerje kirorgjike po ashtu I njejtja eshte leshuar ne gjendje imonbolizimi permes gipsit me tutje kurimi I tij neper istucionet shendetesore sikurse ne maqedoni ashtu edhe ne Kosove per keto jane edhe raportet mjekesore bashkangjitur lendes e natyrisht ne I kemi permendur siq jane lexuar ne procedure ne seancen e shqyrtimit gjyqsor per kete eshte fotodokumentacioni qe deshmojn shkallen e lendimeve te te pandehurit .

Mbrojttesi I te pandehures deklaroi edhe me tutje mbesim pran deklarateve te dhena ne fjalen hyrese te dhene po ashtu deklaroi se I referohet aktgjykimit te shkalles se dyte dhe vrejttet qe I ka dhene gjykata e apelit.

E pandehura I bashkangjitet fjales perfundimtare te mbrojturit te saj .

Gjykata perkatesisht gjyqtari I vetem gjykues siq edhe I ka analizuar provat ia ka vertetuar faktet dhe I ka specifikuar edhe ne kete faze te procedures penale sipas edhe te aktgjykimit te gjykates se Apelit .

Gjykata mbështetur në të gjitha provat që janë administruar gjatë zhvillimit të seancave analizimit të tyre dhe krahasimit duke i zberthyer dhe administruar një nga një dhe të gjitha se bashku me kujdes të veqante vertetoi gjendjen faktike dhe njekohesisht konstatoi duke qene e bindur se e pandehura ka kryer veprën penale e cila i veket në barre sipas aktakuzës. Andaj për të njejten edhe e shpalli fajtor duke ia shqiptuar denimin me burg në kohezgjatje prej gjashte muajsh e të cilin denim me pelqimin e tij iu zevendesua me denim me gjobe në shume prej 1,700 (njimijeshtatqindeuro)€euro).Gjithashtu ,gjykata ja caktoi edhe ne emer te shpenzimeve gjyqesore procedural siq jane te pricizuar ne dispozitiv te keti akgjykimi,ndersa per realizimin e kerkeses pronesore juridike te demtuarin e udhezoi ne contest te rregullt juridiko-civil.

Gjykata sipas parashkreses qe ka paraqitur familjaret e te demtuares I njejtj gjendet I shtrir dhe ka psuar sulm kardiak .Si do qe te jete I njejtj ka dhene deklaratat me heret per qka jane lexuar ne kete séance te shqyrtimit gjyqesor.

Bazuar ne keto prova dhe fakte , duke I administruar ne tersi gjykata dhe I vlrsuar siq dhe konsatoi se ne veprimet dhe mosveprimet e te te pandehures ekzistojn elementet e tiparet esenciale te , Asgjesimi, demtimi apo heqja e paisjeve mbrojtese dhe rrezikimi I siguris nga vendi I punes nga neni 358 par 5 dhe 3.2 nr. 06/L-074 te KPRK-es.Andaj duke u vertetuar gjendja faktike ne kete faze te procedures penale gjykata te njejtin edhe e shpalli fajtor duke ja shqiptuar denimin me gjobe ne shume prej 1700 euro I cili denim natyrisht u zevendesuar me pelqimin e te pandhures e dhene ne prani te mbrojtetit dhe prokurorit te shtetit nga denimi me burg ne kohezgjatje prej 6 muajsh -konform nenit 44 par 1 dhe 2 te KPRK-es .

Gjykata konsideron se denimi I shqiptuar eshte propocion ne rrezikshmerin shoqerore te vepres penale nga se ne kete raste gjykata ka mare per baze rrezikimin e shoqeris te personave dhe ambientit ku eshte kryer vepra penale ku ka ndodhur dhe renja e te demtuarit .Merastin e shqiptimit te llojit dhe lartesis se denimit gjykata morri per baze rrethanat lehtesuse te percaktuara ne nenin 69 duke mare per baze shkallen e pergjegjesise penale te te pandehures ,motivet per kryerjen e vepres penale intenzitetit te rrezikimit te vleres se mbrojtur sijelljet e me parshme te kryerjes se vepres penale te te pandehures ne kete rast .Pastaj gjykata vlerson se denimi I shqiptuar eshte ne propocion me peshen e vepres penale ,po ashtu gjykata ka marre per baze rrethanat e zbutjes se denimit duke pasur per baze gjithemon se ne kete rast e pandehura nuk ka pasur ndoni motiv te veqant te kryerjes se vepres penale porse me nji menyre po tjeter e njejtja eshte dashte te kete vemendje dhe te jete ne vegjilent kur konsumatoret rrezikohen po ashtu gjykata vendimin mbi denimin e zbatoi ne ate se e pandehura nuk eshte ne evidence penale qe ka krkyer ndoni veper penale ka pasur sjellje korrekte dhe bashkepunim te mirefillt ligjore edhe permes mbrojtetes se saj .Andaj gjykata konstaton dhe vlerson se eshte arritur qellimi I denimit konform nenit 38 te KPRK-es e qe reflektohet ne parandalimin dhe prentivin e kryesve te veprave penale qe te shmangen

veprimeve te kunder ligjeshem qe te qojn ne kriminimin te veprave penale apo te ngjashme. Ngritjen e vetedise dhe gjykimi shoqeror te te pandehures.

Gjithashtu qellimi I denimit konsiston dhe ne faktin e rehabilitimit dhe socializimit pas kryerjes se vepres penale ndergjegjeshmeris dhe pershtateshmeris ne rrethanat ligjore.

Vendimi mbi obligimin e të pandehurit që të paguaj paushallin gjyqësor bazohet në nenin 450 par. 2 nën par 6 të KPK.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasuroro juridike u muar në bazë të nenit 463 par. 1 të KPPRK.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

P.nr. 101/20

**Sekretarja juridike,
Hanife Ibrahim**

**GJYQTARI
Selman Salih**

UDHËZIM JURIDIK;

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15.

Dite nga dita e marrjes së të njejtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së

Apelit në Prishtinë nëpërmes të kësaj gjykate.